



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
T I R A N Ë

NR. Regj. Themeltar

Dt. 13.10.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

GJYQTAR ALTIN ABDIU

asistuar nga sekretare gjyqësore Elona Molla, dt.13.10.2015, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike kërkesën penale që u përket;

Ankues: **N. P.**, i biri i M. dhe i O., i dtl 01.04.19..., lindur dhe banues ne Tirane, ne adresen rruga “Shyqri Ishmi”, shtetesi dhe kombesi shqiptare, arsim i mesem, i pa pune, i martuar, idendifikuar me karte idenditeti, i perfaqesuar me prokure te posaçme nga av.Sokol Shehi.

Prokuroria Prane Gjykates Se Rrethit Gjyqësor Tiranë, perfaqesuar nga prokurori Gjergji Tako.

Objekti : Kundershtim i sekuestros se bere nga policia gjyqesore.

Baza Ligjore : Nenet 301 e vijues te K.Pr.Penale.

Në konkluzionet përfundimtare:

Perfaqesuesi i ankuesit kërkoi pranimin e kërkeses, vleresimin e paligjshëm të sekuestros së vendosur në datën 10.12.2014. Kthimin e mjetit ankuesit. Prokurori kërkoi rrëzimin e kërkeses ankimore si të pa bazuar në prova dhe në ligj.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në teresi,

V E R E N

Me kërkesën ankimore të paraqitur për gjykim ankuesi N. P. kërkon, vleresimin e paligjshëm të sekuestros së vendosur në datën 10.12.2014 mbi automjetin e markës “BMW 525”, me targa TRE, me ngjyre të zeze, numer shasie WW.....03 dhe kthimin e mjetit.

Nga hetimi gjyqësor i kërkeses, e cila është në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj Gjykate ka rezultuar se :

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është depozituar kallezimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor. Ky institucion ka kallezuar faktet që lidhen me automjetin me targa 4.....E TR të markës “BMW” 525, në pronësi të shtetasit N. P. për parregullsi të numrit të shasise së këtij automjeti.

Me vendimin e datës 10.12.2014 prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal me arsyetimin se faktet e jashtëligjshme të përshkruara në këtë procedim penal nuk mund të hetohen penalisht me tej, pasi përfshihen nga Instituti i Parashkrimit.

Prova materiale e sekuestruar, automjeti me të dhenat e mesipërme të lihet në disponim të shtetit pasi nuk dihet pronari i vertetë i tij.

Vendimi i prokurorisë është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr Regj.Themeltar të datës 09.03.2015, pasi u ankimua nga pala anukese N. P..

Në këtë gjykim prokurori kundërshtoi pretendimet e paraqitura nga pala anukese dhe shpjegoi se nuk kemi të bëjmë as me sekuestro preventive, as me sekuestro konservative, pasi këto lloje sekuestro janë kompetencë e gjykatës, kemi të bëjmë me disponimin sipas nenit 190/1-ç të

proves material ne vendimin perfundimtar. Vendimi i pushimit nuk eshte cenuar dhe eshte ne fuqi. Ankimi i pales ankuese i paraqitur per gjykim nuk ka baze ligjore qe te pezulloje efektet e vendimit te pushimit.

Gjykata arsyeton se ne rastin konkret kemi te bejme me disponimin e proves material me nje procedimi penal per te cilin eshte vendosur pushimi i hetimeve. Pala ankuese e ka kundërshtuar vendimin e pushimit te ketij procedimi dhe aktualisht konform procedurave ligjore i eshte drejtuar Gjykates se Apelit Tirane.

Ne keto kushte, Gjykata çmon se kerkesa ankimore duhet rrezuar si e pa bazuar ne prova sepse, kerkimet e paraqitura ne kete gjykim i perkasin nje procesi tjetër gjyqësor me objekt kundërshtimin e vendimit te pushimit te procedimit penal Nr te vitit 2013, te cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e ka gjykuar me vendimin Nr Regj.Themeltar te dates 09.03.2015 dhe aktualisht pala ankuese per kete çështje ka ankimuar vendimin e mesiperm.

PER KETO ARSYE

ne zbatim dhe te neneve 379-384 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I

1. Rrezimin e kerkeses penale Nr..... Regj. Themeltar te dates 08.05.2015.
2. Shpenzimet proceduriale siç jane bere.
3. Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.
4. U shpall ne Tirane, me date 13.10.2015.

S E K R E T A R E
ELONA MOLLA

G J Y Q T A R
ALTIN ABDIU